



AKT – THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“Fatjon” SH.P.K.

Une i quajtur *Bashkim Gjoka* lindur dhe banues ne *Kukes* ne baze te ligjit 7512 date 10.08.1991 dhe te Ligjit 7638 date 19.11.1992 “Mbi shoqerite tregtare “ vendosa te :

THEMELOJ

Shoqerine tregtare private e emertuar me emerin “Fatjon” SH.P.K .

NENI 1

Formohet shoqeria tregtare private e emertuar shkurt “Fatjon “ SH.P.K” me pergjegjesi te kufizuar me ortak te vetem z.Bashkim Gjoka.

NENI 2

Selia e shoqerise ndodhte ne *Kukes*.

NENI 3

Veprimtaria e shoqerise do te jete me nje afat 10 vjet.

NENI 4

Objekti I veprimtarise se shoqerise eshte : **Ne fushen e ndertimeve sipas leccenses Nr. 3527 si ne punime dheu, sistemime , taracime terrenesh etj, ndertime civile dhe ekonomike nderttime rruge kategoria V dhe IV, kanalizime, ndertime vepra kullimi ujitje toke e impiante vaditese , punime mbrojtje dhe sistemimi hidraulik, rikonstruksione godinash civile e ekonomike , veshje fasadash etj , per projektim ujsjellesi te jashtem e kanalizime kat.2 , a,q,c,d, si dhe Shitblerjen me shumice e pakice, eksport – import te mallrave te ndryshem industriale, ushqimore, ushqim social, bar bufe, konfeksione, tekstile, pajisje elektroshtepiake, hidrosanitare, elektronike, materiale ndertimi , hapje dhe shfrytezim motelesh, baresh, restorante , qendra pushimi e kurative, transport mallrash e udhetaresh brenda dhe jashte vendit.**

NENI 5

Kapitali I shoqerise eshte 100000 lek I derdhur nga ortaku I vetem z, Bashkim Gjoka .

NENI 6

Veprimtaria e shoqerise shtrihet prej 1 Janarit deri me 31 Dhjetore te cdo viti.

NENI 7

Veprimtaria e shoqerise pasqyrohet ne bilancin e shoqerise.

NENI 8

Mosmarveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise me te trete ose me punonjesit kur ato nuk mund te zgjidhen me mirkuptim , ceshtja I kalon per kopetence Gjykates .

NENI 9



Shperberja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cfardo shkak ,duke vepruar sipas kriterëve te pershkruar ne kete statut.

NENI 10

Shoqeria "Fatjon" SH.P.K ka vulen e saja .

NENI 11

Me statutin qe I bashkengjitet ketij akti themelimi percaktohen kerkesat ligjore kryesore, per themelimin e saja ,te drejtat dhe detyrat e ortakut te vetem ,administratoreve

NENI 12

Ky akt themelimi perpilohet ne kater kopjo per tu shperndare ne organet kopetente dhe nje kopjo I ngelet vete shoqerise "Fatjon" SH.P.K.

Akti I themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaku I vetem .

THEMELUISI I SHOQERISE

ORTAKU I VTEM
BASHKIM GJOKA

STATUTI

I

SHOQERISE TREGTARE PRIVATE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR E QUAJTUR "FATJON" SH. P K. ORTAK I VETEM

Statuti I Shoqerise Tregtare Private "Fatjon" Sh p k eshte akti baze ku do te mbeshtetet ajo per organizimin dhe zhvillimin e veprimtarise. Shoqeria themelohet nga ortakut I vetem dhe Administrator I saj, nga z.Bashkim Gjoka.

K R E U I

FORMA, EMERTIMI, KOHE ZGJATJA, OBJEKTI I VEPRIMTARISE.

N E N I 1

Shoqeria formohet ne mbeshtetje te Legjislacionit shqiptare ne fuqi dhe eshte I formes se Shoqerive Tregtare Private me pergjegjesi te kufizuar.

N E N I 2

Shoqeria Tregtare Private eshte e emertuar "Fatjon" SHPK

N E N I 3

Selia e shoqerise do te jete ne Kukes.

N E N I 4

Shoqeria do te kete nje kohe zgjatje me nje afat mbi 10 vjet. Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe dhe per cfar do shkakut me vendim te Ortakut te Vetem themelues te saj.

N E N I 5

Shoqeria mund te hapi dhe vend qendrim te reja te dyta, pra aktiviteti I saj do te kryhet ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise ne menyre ambulatorie, me njesi apo mund te celi zyra, perfaqesi apo filiale, si dhe me miratim te organeve kopetente edhe jashte vendit. Selia e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Ortakut te vetem.

N E N I 6

Objekti I veprimtarise se Shoqerise do te jete: Ne fushen e ndertimeve sipas licenses Nr. 3527 si ne punime dheu, sistemime, taracime terenesh etj, ndertime civile dhe ekonomike, ndertim rrugeshe kategoria V dhe IV, ndertim vepra arti rrugor dhe hekurrodhore, ndertime ujsjellesi dhe kanalizime, ndertim vepra kullimi ujitje toke e impiante vadites punime mbrojtje dhe sistemi hidraulik, rikonstruksione godinash ciovile e ekonomike, veshje fasadash etj, per proktim ujsjellsash te jashtem e kanalizime kat. 2 a, q, c, d di dhe Shitblerjen me shumice e pakice, eksport - import te mallrave te ndryshem industriale, ushqimore, ushqim social, bar bufe, konfeksione, tekstile, pajisje elektroshtepiake, hidrosanitare, elektronike, materiale ndertimi, hapje dhe shfrytezim motelesh, baresh, restorant, qendra pushimi e kurative, transport mallrash e udhetaresh brenda dhe jashte vendi etj.

N E N I 7

Per kryerje e veprimtarise se saj Shoqeria do te hape njesi perpunuese, tregtare dhe sherbimi si dhe do te bashkpunoje me persona fizik dhe juridik, vendas dhe te huaj.

K R E U 2

KAPITALI THEMELOR, KONTRIBUTET dhe pjeset e KAPITALIT
N E N I 8

Kapitali themelor I Shoqerise do te jete 100 000 lek, I derdhur ne te holla nga Ortaku I vetem I saj z. Bashkim Gjoka

Ky kapital mund te rritet ose te zvogelohet nga Ortaku I vetem I saj, por nuk mund te ulet nen kufirin 100 000 lek.

N E N I 9

I gjithë kapitali është I ndare ne 100 pjesete barabarta te sejcilit pjese, pjese qe jane nga 1000 lek secila.

N E N I 10

Pjeset e kapitalit themelor jane te transferueshme plotesisht ne rruge trashegimie, ne rast ndarie pasurore midis bashkeshorteve.

Pjeset e kapitalit mund te transferohen dhe personave te tjere qe nuk bejne pjese ne Shoqeri, por gjithmon me vendim te Ortakut te vetem.

N E N I 11

Fitimi I realizuar nga ushtrimi I aktivitetit ekonomik te shoqerise do te administrohet nga Ortaku I vetem I Shoqerise. Nje pjese e ketij fitimi mund te perdoret per zgjerimin e aktivitetit tregtare. Shoqeria eshte e detyruar te shlyeje te gjitha detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe te treteve.

N E N I 12

Shoqeria Tregtare Private eshte "Fatjon " SH . P . K . dhe eshte disponuese e perdoruese e pasurise se saje.

K R E U III

MARJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI dhe KONTROLLI I SHOQERISE
N E N I 13

Te gjitha vendimet meren nga Ortaku I vetem, I cili zevendeson Asamblen e Shoqerise z. Bashkim Gjoka, I cili eshte dhe Administrator I Shoqerise. Themeluesi I Shoqerise ka ne kopotence te caktoje si Administrator edhe persona te tjere, te cilet nuk kane cilsine e Ortakut.

N E N I 14

Administratori ka per detyre organizimin dhe drejtimin e veprimtarise te Shoqerise. Ai mund te kryej te gjitha veprimtarite ne interes te Shoqerise.

N E N I 15

Ne mardhenie me te trete Administratori e angazhon Shoqerine nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

N E N I 16

Ortaku I vetem themelues ka ne kopotence , duke mare vendime te tilla, te miratoje programin e Shoqerise, te hartoje raportin e Administratorit te inventarit dhe llogarite vjetore. Vendos per shperndarjen e Shoqerise. Rregullon marrdheniet e punesimit dhe te shperblimit te Shoqerise. Emron dhe shkarkon Administratoret ekspertkontabel, ndryshimet ne Statut dhe ne AKTIN E THEMELIMIT, per zvogelimin apo te shtimit te kapitalit etj.

N E N I 17

Shoqeria mban dokumentacione rregullt te veprimtarise ekonomiko-financiare ,I pasqyron ato ne kontabilitet dh ene bilancet e saj.

N E N I 18

Administratori ka te drejte te njihet me veprimtarine e Shoqerise dhe me dokumentet e saj.

N E N I 19

Administratori kur eshte I zgjedhur shkakohet nga Ortaku I vetem.

N E N I 20

Ortaku themelues eshte pergjegjes individualisht ndaj Shoqerise dhe te treteve per shkeli et e Ligjeve.

N E N I 21

Kontroli financiar I Shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel I autorizuar dhe I emruar.

K R E U IV

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE dhe REZERVAT E DOMOSDOSHME

N E N I 22

Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Llogarite vjetore ,inventari, raportet dhe operacionet e vitit miratohen nga Ortaku I vetem .Miratimi I dokumentave mbi veprimtarine financiare vjetore behen brenda nje afati tre muaj pas mbylljes se vitit financiar.

N E N I 23

Mbas miratimit te llogarive vjetore dhe te evidentimit te ekzistences te fitimit ,Ortaku I vetem vendos zbritjen nga fitimi per krijimin e fondit te rezervave ligjore ,si dhe per perdorimin e pjeses se fitimit.

N E N I 24

Ne veprimet kontraktuale Shoqeria perfaqsohet nga Ortaku I vetem ose nga persona te tjere te caktuar prej tij.

N E N I 25

Shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal, sig. shoq. etj. Ajo ka te drejte te celi llogari likujduese prane bankave te vendit.

N E N I 26

Per pasqyrimin e aktivitetit privat Administratori apo persona te tjer te caktuar prej tij jane te detyruarte mbajne dokumentacion te rregullt.

K R E U V

N E N I 27

Ortaku themelues vendos per shtimin ose paksimin e Ortakeve dhe personave te tjere te punesuar ne veprimtarine e Shoqerise.

N E N I 28

Marrdheniet e punes brenda Shoqerise rregullohen me kontraten e punes

N E N I 29

Largimi nga Shoqeria behet pasi te jene shlyer detyrimet materiale dhe monetare .

K R E U VI

N E N I 30

Shoqeria mund te prishet para afatit te percaktuar ne kete STATUT kur ka nje prishje te detyrueshme te parakohshme per shkelie te ndryshme.

N E N I 31

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi emrohen nje ose me shume likujdatore, te cilet ne fund paraqesin nje raport mbi rezultatin e likujdimit .Ortaku I vetem themelues I Shoqerise ben miratimin perfundimtar te procesit te likujdimit dhe vendos per heqjen e mandatit te likujdatorit.

N E N I 32

Pasi shlyen te gjitha detyrimet qe Shoqeria u ka te treteve ,personave juridik apo fizik behet njoftimi I mbylljes ose I likujdimit te Shoqerise duke e crregjistruar ate dhe ne rregjistrin tregtare prane Gjykates se Tiranës.

N E N I 33

Ndryshimi I Shoqerise ne nje Shoqeri tjetër behet me vendim te Ortakut te vetem ,kur plotesohen kushtet per krijimin e Shoqerive te llojeve te tjera.

N E N I 34

Te gjitha marrdheniet qe mund te lindin ndermjet Shoqerise dhe te punesuarve apo personave te tjere te trete, kur ato nuk mund te zgjidhen me mikuptim, zgjidhja mbetet ne koptence te Gjykates.

N E N I 35

Ceshtjet e tjera qe nuk jane trajtuar ne kete STATUT ,gjithcka I referohet Ligjes Nr.738 dt.19.11.1992 "Mbi Shoqerite Tregtare " ne vecanti ,si dhe Legjislacionit shqiptar ne fuqi, si dhe akteve te tjera ligjore e nenligjore te dale ne zbatim te tyre.

N E N I 36

Themeluesi I Shoqerise ne cdo kohe mund te beje ndryshime e plotsime ne STATUT pa rene ndesh ne menyre thelbesore me nenet qe jane pershkruar ne kete statut. Ndryshimet e plotsimet e ketij Statuti behen ne te njejten menyre e procedure me te cilen nxirret vet Statuti.

N E N I 37

Shoqeria ka vulen e saj

N E N I 38

Statuti perpilohet ne disa kopje per tu shperndar organeve kopetente dhe nje kopje mbetet me dokumentacionin baze te Shoqerise.

Statuti u hartua ne TIRANE me dt 03.03.1998.

ORTAKU THEMELUES E ADMINISTRATOR I
SHOQERISE

BASHKIM GJOKA

